

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Zyra e Komisionerit ka hartuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili ka për qëllim të përmirësojë dhe forcojë rregullat dhe procedurat e legjislacionit aktual për të drejtën e informimit.

Disa nga risitë që sjell projektligji janë:

- Krijimi i një Bordi Këshillimor, i cili do të funksionojë si një strukturë këshilluese dhe do të shërbejë si një mekanizëm për rekomandime mbi zbatimin sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të ligjit për të drejtën e informimit;
- Përfshirjen në programin e transparencës, të vendimmarrjes së organeve të prokurorisë për veprat penale që kanë interes të lartë publik, sipas përcaktimeve të bëra në programin model të transparencës të miratuar nga Komisioneri për këtë kategori autoritetesh publike.
- Mundësinë e sanksionimit të personit përgjegjës për refuzimin e dhënies së informacionit, përveç rasteve kur përgjegjës është koordinatori;
- Përcaktimin e vendimit të Komisionerit si titull ekzekutiv me kalimin e afatit të përcaktuar në vendim;
- Koordinatorin për të drejtën e informimit, të përfitojë një shtesë page për natyrë të veçantë pune.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit, më 24 Nëntor 2021, ka depozituar pranë Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e institucionit lider të Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, së bashku me aktet shoqëruese, për të vijuar më tej me procedurat deri në miratimin e tij.

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Me vendimin nr. 60, datë 07.12.2021, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë" (Autoriteti Publik), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", në të cilin kërkohej informacion mbi:

"Pagesën totale të Autoritetit Kontraktor, në rastin e kontratës koncesionare/PPP mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompanisë "Gjoka Konstruksion", me objekt "Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e "Rrugës së Arbrit"; vlerën që do të investojë kompania në fjalë pas rastit të shembjes së Tunelit të Murrizit dhe nëse ka patur ndryshim të kontratës mes Autoritetit Kontraktor dhe kompanisë "Gjoka Konstruksion".

Gjithashtu kërkuar informacion nga autoriteti publik se kush do të paguante koston prej 17.5 miliard lekë me TVSH (buxheti i shtetit apo kompania koncesionare); vlerën e preventivit të zbatimit të projektit "Aleternativa B për Tunelin e Murrizit"; pjesën e kontratës koncesionare/PPP mes Autoritetit Publik dhe kompanisë "Gjoka Konstruksion" "Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e "Rrugës së Arbrit" dhe nëse kjo kosto do të përgjysmohej, çfarë vlere do të paguhej për këtë alternativë nga buxheti i shtetit, si dhe konsultimet me Avokaturën e Shtetit lidhur me pretendimet për pagesën e kostove të Alternativës B të Tunelit të Murrizit".

Në mungesë të një përgjigje nga ana e Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, kërkuar ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", (në vijim LDI).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, Komisioneri ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit, Autoriteti Publik në përgjigjen e tij argumentoi se "...Pagesa që Autoriteti Kontraktor do të realizojë ndaj palës në Kontratën PPP është sipas modelit financiar dhe do të bëhet në bazë të kësteve të disponueshmërisë, të përcaktuara në VKM nr. 180/2018, me anë të së cilës është miratuar kontrata e Koncesionit/PPP ndërmjet (...) publikuar në Fletoren Zyrtare me Nr. 50, datë 11.4.2018. Për sa i përket kërkesës nëse kontrata ka patur ndryshime, Autoriteti Publik sqaron se Kontrata PPP "Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e Rrugës së Arbrit", nuk ka pësuar ndryshime, nga ajo e miratuar, me VKM-në e sipërcituar. Përsa i takon kërkesës "Nëse ka patur konsultime me Avokaturën e Shtetit lidhur me pretendimet për pagesën e kostove të Alternativës B të Tunelit të Murrizit, Autoriteti Publik në përgjigjen e saj nuk informoi nëse ky këshillim kishte ndodhur apo jo.

Zyra e Komisionerit vlerësoi se gjatë hetimit administrativ, Autoriteti Publik, nuk është përgjigjur kërkesës për informacion dhe nuk provoi në asnjë moment se është në kushtet e nenit 17, të LDI për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, duke qenë se është ky nen, i cili parashikon shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Në këto kushte, Komisioneri vlerësoi se, informacioni i kërkuar në kërkesën për informacion, përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokument, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë edhe nenin 17, të ligjit të sipërcituar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

Indeksi i Transparencës së Autoriteteve Publike



INDEKSI I TRANSPARENCËS AUTORITETEVE PUBLIKE 2021

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale publikon për vitin e dytë radhazi Raportet mbi “Indeksin e Transparencës së Autoriteteve Publike Qendrore dhe të Varësisë 2021” dhe “Indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore 2021”.

Këto indekse ndjekin një metodologji të caktuar, e cila shërben kryesisht për të sjellë një analizë krahasuese të nivelit të transparencës proaktive të autoriteteve publike, duke krahasuar trendin e transparencës së tyre ndër vite. Gjetjet e këtyre raporteve synojnë jo vetëm të nxisin ndërgjegjësimin për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, si dhe rritjen e nivelit të transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit, por shërbejnë dhe si referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.

Nga monitorimi i realizuar, konstatohet një rritje e transparencës proaktive në autoritetet publike qendrore dhe të varësisë, si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore, përsa i përket plotësimit të Programit të Transparencës, përmbajtjes së informacionit të tij, regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve, në raport me vitin e kaluar.

• • • •


Instrumenti i parë “Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, u zhvillua gjatë muajve shtator-dhjetor 2021. Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 5 treguesve kryesorë, të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore. Metodologjia e matjes u bazua në 5 tregues kryesorë:

- publikimi i programit model të transparencës;
- përditësimi i regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2021;
- publikimi i të dhënave të koordinatoreve;
- publikimi i të dhënave të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin me publikun;
- publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2021.

Në konkluzion të monitorimit të Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore gjatë vitit 2021, vërejmë se në krahasim me vitin 2020, kemi një rritje të transparencës proaktive, veçanërisht në 3 kategoritë e informacionit: "Publikimi i programit model të transparencës" (93%), "Përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve" (90%) dhe "Publikimi i të dhënave të koordinаторit për të drejtën e informimit" (78 %). Ndërkohë që kategoria e informacionit "Publikimi i të dhënave të koordinаторit për njoftimin dhe konsultimin me publikun" (52%) dhe "Publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2021" (67%) nuk është në të njëjtat nivele.

••••


Instrumenti i dytë "Indeksi i Transparencës së Autoriteteve Qendrore dhe të Varësisë 2021", ka të bëjë me matjen e transparencës proaktive të 100 institucioneve qendrore (kryeministria dhe ministritë, institucionet e tyre të varësisë, institucionet e pavaruara, gjykatat, prokuroritë, universitetet, shoqëritë anonime ku shteti zotëron pjesën më të madhe të aksioneve, si dhe një pjesë e institucioneve të sistemit të drejtësisë) si dhe hartimin e raportit përkatës. Metodologjia e përdorur i referohet 5 treguesve kryesorë e njëjtë si tek monitorimi i njësive të vetëqeverisjes vendore. Rezultatet e këtij monitorimi tregojnë se të gjitha autoritete publike qendrore dhe të varësisë të shqyrtuara në këtë raport kanë publikuar



INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE TË VARËSISË DHJETOR 2021



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE



INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE TË VARËSISË DHJETOR 2021



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Programin Model të Transparencës së Rishikuar në faqen zyrtare të autoriteteve publike (100%), sipas Urdhrit nr. 187, dt. 18/12/2020 "Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar", i ndryshuar.

Në të njëjtin trend është edhe indikator i "Publikimi i të dhënave të koordinаторit për të drejtën e informimit", ku 94 autoritete publike përkundrej, 100 autoritete publike (94%) të monitoruara, e kanë publikuar informacionin përkatës plotësisht ose pjesërisht.

Në lidhje me regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, monitorimi evidenton me pikë pozitive vetëm ato raste kur regjistri është përditësuar gjatë vitit 2021. Numri total i autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë, të cilët kanë përditësuar regjistrin e kërkesave plotësisht, ose pjesërisht është 81, përkundrej 100 autoritete publike të monitoruara, çka përbën 81 % të autoriteteve publike që kanë zbatuar detyrimin ligjor për përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Nga ana e autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë, janë konstatuar mangësi më të theksuara në publikimin e informacionit proaktiv, i cili ka të bëjë me "Publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2021", ku

rezulton se kanë publikuar pjesërisht ose plotësisht buxhetin e vitit 2021, vetëm 57 autoritete publike, përkundrej 100 të monitoruara (57%). Ndërkohë gjatë vitit 2021 është monitoruar edhe detyrimi për përcaktimin e një koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik i cili duhet të jetë i publikuar edhe në programin e transparencës. Për qëllimin e këtij raporti, institucionet e drejtësisë (26 në total) janë shënuar me 1* në indikatorin e vlerësimit, duke mos e konsideruar në llogaritjen përfundimtare. Nga 74 autoritetet e tjera publike, rezulton se 23 (31%) prej tyre kanë publikuar të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik plotësisht ose pjesërisht ndërsa autoritetet e tjera, ose nuk e kanë publikuar, ose e vetëpërgjashtojnë autoritetin publik nga detyrimet e ligjit nr.146/2015 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".